



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor

Mbledhja nr. 36

Prishtinë, më 6.4.2016, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

i mbledhjes së komisionit për bujqësi, pylltari dhe mjedis e planifikim hapësinor

Në mbledhje morën pjesë : Duda Balje, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Srdjan Popoviq,
Emilija Redzepi, Shaip Muja.

Munguan : Haxhi Shala, Salih Salihu.

Të ftuar dhe pjesmarrës tjerë sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit : Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Duda Balje**, kryetare e komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 29.3.2016,
3. Shqyrtimi i rekomandimit për mbledhjen plenare për bordin e mjedisit,
4. Te ndryshme ;

Kryesuesja **Duda Balje** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 29.3.2016

Procesverbali nga data 29.3.2016 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i rekomandimit për mbledhjen plenare për bordin e mjedisit

Kryesuesja hapi diskutimin rreth kësaj pike duke përshëndetur anëtarët e bordit të propozuar nga Qeveria dhe konstatoi se problemet mjedisore në Kosovë janë mjaft voluminoze çka e ka shtyrë këtë komision të ftoi paraprakisht anëtarët e propozuar për bashkëbisedim. Ajo fillimisht sugjeroi të parashtrohen pyetjet apo sugjerimet nga komisioni pastaj të zhvillohet debati me anëtarët e propozuar të këtij bordi.

Anëtarët e komisionit **Adem Salihaj, Shaip Muja, Emilija Redzeqi, Murat Hoxha, Srdjan Popoviq dhe Kryesuesja Duda Balje** parashtruan pyetje të përgjithshme dhe parimore rreth strategjisë mjedisore që do të hartohet nga Qeveria dhe për rolin e këtyre anëtarëve sa do të mund të ndikojnë në çështjet mjedisore. Gjithashtu u debatua rreth rëndësisë së bordit që do të ishte për komisionin ngase në kuvend siç dihet është miratuar para pak kohësh raporti mjedisor ndërsa ky komision nuk ka mbështetur atë raport, kjo flet se sa do të ishte e domosdoshme me pas komisioni një shkresë profesionale me të cilin do të mbronte qëndrimin negativ për një çështje konkrete, etj.

Behxhet Mustafa u mundua të përfshijë çështjet kryesore për të cilat u interesuan anëtarët e komisionit dhe sqaroi se Bordi i themeluar më 2010 pikërisht ka qenë rezultat i presioneve ndërkombëtare dhe vendore, mirëpo zhgënjimi ka pasuar gjatë punës së bordit mjedisor ngase kushtet për të punuar ky bord as për së afërmi nuk janë plotësuar, ndaj duke sqaruar se 30% të pyetjeve nga BE do të janë të fushës së mjedisit dhe bujqësisë, ai alarmoi komisionin se puna e këtij bordi, edhe pse këshillëdhënës e jo ekzekutiv, do të jetë e domosdoshme për afirmimin e mëtejshëm të Kosovës në këtë fushë dhe përafrim me Acqui. Ai më tutje prezantoi një nga një anëtarët e propozuar nga të cilët njëri mungonte (**Naser Ramadani**) dhe theksoi rëndësinë e fushave që do të përfaqësojnë ata fillimisht pranë këtij komisioni e pastaj edhe më gjerë. Ai duke treguar edhe disa përvoja me komisionin e kaluar parlamentar, potencoi problemin kryesor financiar rreth funksionimit të këtij bordi për të cilin Ministri i tanishëm i MMPH ka premtuar angazhim të përbashkët me këtë komision menjëherë pasi të miratohet rekomandimi në mbledhjen plenare. Gjithashtu edhe anëtarët tjerë në vazhdim **Naser Sahiti (energjetikë), Islam Fejza (gjeologji), Nysrete Doda (bujqësi), Tush Markaj (ujëra) dhe Fatos Lajçi (shoqëri civile)** secili veq e veq njoftuan komisionin për gjendjen aktuale mjedisore, kurse në përfundim z. Mustafa dorëzoi edhe rregulloren e miratuar në Qeveri rreth funksionimit të bordit e cila mund të shërbej për takimin që propozoi z. **Shaip Muja** pas miratimit të bordit në mbledhjen plenare, duke potencuar se me këtë bord Kosova më shpejt mund të arrin tek mbështetjet financiare që ofron sidomos Brukseli për këtë fushë. **Fatos Lajçi** tregoi për zbulimin e species shtazore reqebullit në Kosovë dhe rëndësinë

mjedisore që ka ky fakt në një shtet por fatkeqësisht siç tha ai Kosova edhe këtë fakt nuk mund të aktualizoi dhe të përfitoi nga ajo për shkak të mos përkrahjes institucionale. **Kryesuesja** gjithashtu u angazhua rreth çështjes financiare gjatë rebalancit në qershor dhe pyeti sa mundet ky bord të kontribuoi nëpër komuna, për të cilin pyetje Behxhet Mustafa u përgjigj me shembuj konkret, mirëpo **Emilija Redzeqi** ishte e mendimit që MMPH ka kapacitete financiare të mjaftueshme për të mbajtur këtë bord rreth funksionimit dhe nuk ka nevojë të angazhohet kuvendi në këtë drejtim.

Komisioni rekomandoi miratimin e propozim vendimit të Qeverisë për anëtarët e Bordit mjedisor.

4...Të ndryshme

Në pikën vijuese Kryesuesja propozoi shqyrtimin e pikave , dhe u vendos si vijon :

- Më 13 prill mbahet mbledhja e komisionit kur është ftuar ministri i bujqësisë për temat e ngjashme sikurse me ministrin e MMPH me fokus për çështjet e ndihmave që ofrohen fermerëve, gjithashtu ftoi anëtarët e komisionit të parashtrojnë përmes stafit pyetje shtesë nëse kanë,
- Me 12 prill mbahet takimi i grupit punues për projektligjin e Obiliqit kur do të hartohen rekomandimet përfundimtare për këtë projektligj,
- Murat Hoxha u angazhua për përfundimin e monitorimit të ndotësve të mdhenj dhe në ditët në vijim të shikohet mundësia edhe një vizite apo të përfundimit të monitorimit,
- Rekomandimi për shpronësime duhet të përfundojë pasi të takohet GP kurse kryesuesja për mbrojtjen nga zhurma duhet të caktoj takimin e GP.

Mbledhja përfundoi në orën 12,40.

Përgatitur nga stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Duda Balje